EUROPEAN CENTRE FOR MINORITY ISSUES KOSOVO

NDËRMARRËSIA E KOMUNITETEVE NË KOSOVË: MUNDËSITË DHE SFIDAT

Dokumenti në vazhdim ka për qëllim të vë theks të veçantë sfidat me të cilat përballen Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme nën pronësi apo menaxhim të pjesëtarëve të komuniteteve minoritare, grupeve të cenuar apo margjinalizuara (GCM-ve) në Kosovë[1], si dhe ka për qëllim dhënjen e rekomandimeve për integrimin efektiv të tyre në mjedisin më të madh kosovar të biznesit.

1. NVM-të në Kosovë: potenciali i madh për rritje ekonomike dhe punësim

NVM-të përbëjnë një sasi të madhe të prodhimit ekonomik në Kosovë dhe afërsisht 62% të fuqisë punëtore[2]. NVM-të kontribojnë rreth 24%[3] në GDP-në e Kosovës në intervale vjetore, përqindje kjo e cila është më e lartë se kombinimi i ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha. Në një kontekst ku rritja ekonomike e Kosovës ka qenë e shtyrë nga ndihmat ndërkombëtare, nga sektori publik dhe nga remitancat (të hyrat nga diaspora),[4] NVM-të kanë kontribuar masovikisht në zhvillimin dinamik të sektorit privat me rezultate të cilat potencialisht janë të dobishme në rritjen e përgjithshme ekonomike.

2. Ndërmarrësia e komuniteteve në komunat e sapo-themeluara: një rast specifik

Edhepse situata në komunat e sapo-themeluara me shumicë serbe[5] nuk është ndihmuar nga kushtet përgjithësisht të dobëta ekonomike në Kosovë, ekzistojnë faktorë të tjerë lokal të cilët e përkeqësojnë më tej situatën. Shumica e komunave kanë zhvilluar ose janë duke zhvilluar plane sa i përkët zhvillimit ekonomik, si dhe qeveria qendrore e Kosovës ka adaptuar një numër të strategjive të sektorëve përkatëse. Në të vërtetë, sipas ligjit, komunat janë përgjegjëse për menaxhimin dhe stimulimin e ekonomisë lokale, zbatimin e legjislacionin në nivelin qendror dhe projektimin e njëkohësisht edhe zbatimin e rregulloreve të cilat mbështesin NVM-të[6].

---

[1] Për hir të këtij dokumenti, personave me nevoja të veçanta, të papunësuarëve, personave në moshë, grave apo kujtdo që është në rrezik më të lartë të ekspozimit ndaj varfërisë apo të mospërfshirjes sociale, u është referuar si GRM.

[2] Swiss Cooperation, Contribution to the Kosovo SME Promotion Programme (KOSME).

[3] SME Development Strategy for Kosovo 2012-2016.

[4] Raporti iBankës Botërore '*Kosovo Unlocking Growth Potential: Strategies, Policies, Actions*', Prill 2010.

[5] Graçanicë, Kllokot, Novobërdë, Partesh, dhe Ranillug.

[6] Lehtësimi i regjistrimit të biznesit: sigurimi i një sistemi të integruar të regjistrimit të biznesit nëpërmjet Qendrave për Shërbime të Biznesit në komuna, ku sipërmarrësit përveç marrjes së çertifikatës së biznesit, mund të pajisen edhe me numrin fiskal, çertifikatën e TVSH-së, dhe me çertifikatën e import-eksportit.
Shih: Facilitation of business registration.

Mbështetur nga:

MINISTRY FOR FOREIGN AFFAIRS OF FINLAND

Megjithatë, në praktikë zyrtarët komunalë si dhe komuniteti i biznesit janë në mungesë të kapacitetit për menaxhimin dhe zbatimin efektiv të planeve dhe strategjive të tilla. Përkundër disa zhvillimeve pozitive të fundit të cilat favorizojnë një mjedis më të përshtatshëm për bizes (p.sh lehtësimin e regjistrimit të biznesit dhe zbatimin e fushatës kundër qarqeve ekonomike informale), kjo mungesë e kapaciteteve gjithashtu vazhdon të pengojë edhe qasjen ndaj fondeve të të dy komunave dhe komuniteteve të biznesit, duke ua vështirësuar atyre qasjen ndaj subvencioneve, kredive, granteve ose ndaj ndonjë mbështjetjeje tjetër të ofruar nga donatorët dhe investitorët e ndryshëm. Për më tepër, interesimi i mbështetsve dhe investetitorëve të kapitalit dikur ishte veçanarisht i fokusuar në ndërmarrjet më të mëdha në Kosovë.[7] Si rezultat i kësaj, shumica e NVM-ve të komuniteteve veprojnë ekskluzivisht në komunat e tyre të origjinës dhe përballen me disa pengesa në rritje dhe zhvillim, duke e pamundësuar zgjerimin e tyre drejt tregjeve të reja ose aktiviteteve më të gjera.[8]

3. Stimulimi/nxitja e ndërmarrësive të komuniteteve minoritare: rruga drejt saj

Qeveria e Kosovës ka identifikuar dhe ka filluar t'i adresojë pengesat e tilla nëpërmjet ngritjes së kornizave ligjore dhe mekanizmave stimulues për promovimin e zhvillimit ekonomik lokal si dhe mbështjetjen e NVM-ve. Për shembull, Ligji për Mbështjetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, themeluar nga Agjensia për Mbështjetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), e cila, ndër të tjera do të mbështesë NVM-të përmes mundësimit të qasjes në kredi, për të parandaluar dhe për të zvogëluar barrierat për biznesin, dhe të lehtësojë komunikimin ndërmjet NVM-ve dhe ndërmarrjeve të mëdha si dhe profesionistëve të tjerë përkatës në përmirësimin e kapaciteteve dhe ekspertizës.[9] Megjithatë, kjo kornizë punuese nuk zbatohet gjithmonë me përpikmëri, veçanërisht në pesë komunat e sapo- themeluara. Për më tepër, komunat nuk kanë sisteme të monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë që të vlerësojnë ndikimin e ligjeve të tilla.

Në mënyrë që të adresohen kufizimet/pengesat e mësipërme, MTI së bashku me AMNVM-në kanë adaptuar Strategjinë e Zhvillimit të Kosovës të NVM-ve.[10] Në Janar të vitit 2012 hyri në fuqi si një komponent nën-sektorial i Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit për Kosovën.

Strategjia adreson pengesat dhe sfidat në të cilat hasin NVM-të sa i përkët zhvillimit të biznesit, investimeve, qasjeve në kredi dhe rritjes ekonomike. Gjithashtu, strategjia ka parasysh rëndësinë e krijimit të mundësive për komunitetet minoritare dhe GCM-ve, si një mjet të krijimit të një mjedisi më paqësor dhe me marrëdhënie më të lehtësuar ndër-etnike. Në mënyrë dominante, Objektivi Strategjik 7 i Strategjisë së Zhvillimit të NVM-ve bën referencë të qartë për përmirësimin e pozitës së GRM-ve përmes vlerësimit dhe trajnimit të nevojave të tyre, nxitjen e programeve mbështetëse për

[7] International Organisation for Migration Kosovo, Support for Entreprise Development in Minority Regions and Community Investment (SEDMIN) project.
[8] Publikimi i ECMI Kosovës „Perspektivat e zhvillimit ekonomik lokal në komunat e decentralizuara të Kosovës" Qershor 2012.
[9] See complete version of the law.
[10] Strategjia e zhvillimit të NVM0-ve në Kosovë 2012-2016.

ndërmarrjet, ofrimin e mundësive të ndryshme financiare si dhe rritjen e qasjes së tyre përmes asistencës teknike ndaj skemës „Voucher".[11]
Një tjetër mënyrë për zgjerimin e mundësive për biznes të NVM-ve që i përkasin komuniteteve minoritare është mbështetja e formimit të shoqatave/asociacioneve.[12] Një shoqatë e tillë biznesi do të përfaqësonte komunitetin lokal dhe do të ishtë një zë mjaftë efektiv dhe i fuqishëm në adresimin e shqetësimeve tek zyrtarët komunalë. Kjo iniciativë në veçanti është ambicje e shoqatës së sapo krijuar nga biznesmenët serbë (ASP, Asocijacija Srpskih Privrednika), shoqatë kjo e cila gjendet në Gračanica/Graçanicë dhe është themeluar në partneritet të ngushtë me komunën.

4. Rekomandimet

ECMI Kosova rekomandon veprimet e mëposhtme për zyrtarët komunalë, organizatat ndërkombëtare dhe komunitetin e biznesit lokal:

- ECMI Kosova i bën thirrje **Ministrisë së Tregëtisë dhe Industrisë** për ta përshpejtuar zbatimin e Strategjisë së NVM-ve pa vonesë, në mënyrë që të arrihet progres dhe të përmbushet Qëllimi Strategjik 7 në lidhje me ndërmarrësinë e komuniteteve minoritare GCM-ve, me theks të veçantë në dhënjen e granteve të vogla si dhe garantimin e kredive;

- ECMI Kosova i bën thirrje **komunitetit të biznesit në Kosovë** që të angazhohet në një dialog konstruktiv me Shoqatën e Biznesmenevë Serb (ASP) dhe me përfaqësues të tjerë të komuniteteve minoritare dhe grupeve të cenuara dhe margjinalizuara, për intergrimin e tyre në rrjete më të gjera;

- ECMI Kosova i bën thirrje **komunave** të angazhohen në mekanizmat e një dialogu të rregulltë dhe sistematik me komunitetet e biznesit lokal në mënyrë që të së bashku të definojnë përmbajtjen e politikave të zhvillimit ekonomik lokal/vendor.

- ECMI Kosova i bën thirrje **komunitetit ndërkombëtarë** të zhvillojë dhe zbatojë strategjitë dhe programet të cilat në mënyrë direkte targetojnë ndërmarrësit e komuniteteve minoritare dhe të GCM-ve, në mënyrë që të stimulohet krijimi/themelimi dhe zgjerimi i bizneseve ekzistuese nga këto grupe.

[11] Skemat „Voucher" ju referohen ndihmave në të ardhmen ndaj NVM-ve përmes shërbimeve të konsulencës dhe trajnimit.
[12] Publikimi i ECMI Kosovës „Perspektivat e zhvillimit ekonomik lokal në komunat e decentralizuara të Kosovës" Qershor 2012.